

INFORMATA MBI GRANTIN

Emri i grantit:	“Komunitetet në këshillat e shkollave”
Instrumenti:	Grant i vogël për projekt
Subjekti zbatues:	Lion’s Club Istogu (LCI)
Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):	Banjë, 31000 Istog, +383 44 363 743; +383 49 766 483; lionsclubistogu@gmail.com
Kohëzgjatja e grantit:	Data e fillimit: 15/05/2022 Data e përfundimit: 15/12/2022
Buxheti total i grantit (EUR):	9,358.00 €
Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):	9,358.00 €
Grupet e synuara:	Rinia Nxënësit me aftësi të kufizuara Nxënësit e komuniteteve rom, ashkali e egjiptian
Shtrirja gjeografike:	Pejë, Istog, Klinë
Përmbledhje e grantit:	Ky projekt ka për qëllim që të instalojë praktika antidiskriminuese në gjashtë shkolla të komunave Pejë, Istog dhe Klinë duke punuar me shkollat në përfshirjen e nxënësve rom, egjiptian e ashkali, dhe fëmijëve me nevoja të veçanta në këshillat e nxënësve të atyre shkollave. Përmes aktiviteve A1. Trajnime me këshillat e shkollave; A2. Trajnime me nxënësit; A3. Punëtori me nxënësit, ku do të marrin pjesë dhe nxënës nga komunitet pakicë dhe fëmijë me aftësi të kufizuara; A4. Ngritja e kapaciteteve të arsimtarëve në gjashtë shkolla; A5. Fushata nëpër shkolla; A6. Hapja e miniekspozitave; A7. Mbikëqyrja e zgjedhjes së këshillave të ri në shkolla, synohen dy rezultate: R1. Nxënësit, mësimdhënësit dhe komuniteti janë vetëdijësuar dhe inkurajuar për procese antidiskriminuese në shkolla, luftimin e paragjykimeve dhe përjashtimit social, dhe R.2 Këshillat e nxënësve në nivel klase e shkolle, grupet tjera punuese në shkollë, komisionet dhe në format e tjera të përfaqësimit në strukturat e shkollës gjatë vitit shkollor 2022/2023 kanë në kuadër të tyre nxënës nga komunitetet joshumicë dhe nxënës me aftësi të kufizuara.

Bashkëfinancuar nga: